

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË POLIÇAN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Poliçan me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik financiar” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 97, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 418/7, datë 30.6.2012, dërguar z. **Adriatik ZOTAJ**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në zërin “Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara” vlera prej 800 mijë lekë “Studime e kërkime” që i takon investimit “Studimi për rikonstruksionin e sheshit Tomorri” duhet të kalojë në vlerën e investimit të AQ.

Menjëherë

2. Faturat tatimore duhet të nënshkruhen nga blerësi dhe të pranohen fatura të thjeshta tatimore vetëm nga subjektet private të licencuara.

Vazhdimisht

3. Të privatizohet si veprimtari thertorja ose të jepet me qira pasi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e therjes nuk mbulojnë pagat e kasapëve e shpenzimet e tjera.

Menjëherë

4. Menaxheri i njësisë së qeverisjes vendore për inventarizimet dhe menaxhimin e aktiveve të marrë masa për ta dokumentuar këtë proces duke nxjerrë: urdhër për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe asgjësimit, lista e aktiveve të identifikura për vlerësim, procesverbali i asgjësimit, relacioni, procesverbali i asgjësimit, relacion për objektet e asgjësuar, fletëdalja, sipas “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Vazhdimisht

5. Të merren masa që komisioni i vlerësimit të ofertave, të emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu V, pika 1, germa ç, 2 germa ç.

Vazhdimisht

6. Dokumentet standarde të tenderit të miratohen edhe nga titullari i autoritetit kontraktor sipas VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 2, germa b.

Vazhdimisht

7. Në kontratat e lidhura për punët publike me periudhë zbatimi deri 6 muaj dëmshpërblimi për vonesat, të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës.

Vazhdimisht

8. Specialistët në zbatim, drejtuesit teknikë dhe administratorët e operatorëve konkurrues duhet të jenë të kontraktuar, të jenë në listë pagesat dhe t'i referohen pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat personale për personelin drejtues e tekniko-ekonomik, nomenklaturës së veprimtarive ekonomike dhe të kërkesave të vendit të punës për kualifikim, sipas klasifikimit në vendin ku ushtrohet veprimtaria e biznesit bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 2/d, VKM nr. 285, datë 4.5.2007, “Për caktimin e pagës referuese mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore” dhe UMF nr. 10, datë 21.6.2007, pika 4/v.

Vazhdimisht

9. Të merren masa që zgjatja e afatit të punimeve nga investitori, të bëhet me kërkesën zyrtare të mbikëqyrësit dhe kërkesës së sipërmarrësit të punimeve, kur këto nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës sipas UKM nr. 2, datë 13.5.2005 kreu I, pika, 7.2, 7.3 dhe kreu II, pika 10.

Vazhdimisht

10. Dokumentet që argumentojnë sasinë, përcaktimin e çmimit të zërave të punimit të preventivit për përcaktimin e kufirit monetar duhet të jenë pjesë e dosjes së prokurimit sipas përcaktimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, pika 2, germa c, ç dhe ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 15, 22.

Vazhdimisht

11. Në funksion të menaxhimit financiar dhe kontrollit, titullari i njësisë publike (Bashkisë), të hartojë politikën, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave. Të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike, i cili të përbehet nga menaxheri kryesor i njësisë publike dhe të kryesohet nga ai vete sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

12. Të ngrihet struktura e auditimit të brendshëm, të miratohen rregullat e funksionit të auditimit të brendshëm dhe të garantohet pavarësia funksionale e tij në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

13. Të hartohen dhe miratohen sistemet e menaxhimit të informacionit në funksion të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

14. Të miratohen akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

15. Nëpunësi autorizues duhet të raportojë tek titullari i njësisë publike për monitorimin, përditësimin, zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Vazhdimisht

16. Të merren masa për hartimin propozimin dhe raportimin për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njëسيا, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë.

Vazhdimisht

17. Të hartohen nga bashkia dhe të depozitohen te Ministri i Financave vetëvlerësimi, deklarata vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike duke respektuar afatet sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2011, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 18.

Menjëherë

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **311,289 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

a. Për punonjësit, ■ 39,164 lekë, ■ 2,506 lekë, ■ 2,506 lekë, ■ 3,468 lekë, ■ 3,877 lekë, ■ 7,304 lekë, ■ 5,014 lekë, që kanë përfituar orë shtesë jashtë kohës normale të punës kur duhej të jepeshin pushime gjatë vitit 2010, në kundërshtim me VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” pika 1, germa “c”, shuma të cilat duhet të kthehen në buxhetin e Bashkisë Poliçan.

Menjëherë

b. Për punonjësit, ■ 40,950 lekë, ■ 24,300 lekë, ■ 24,300 lekë, ■ 25,200 lekë, që kanë përfituar shpërblime për punë të mirë në masën e një page mujore nga fondi i veçantë për vitin 2010, në kundërshtim me VKM nr. 1151, datë 25.11.2009 dhe VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, pika 9 dhe VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, pika 1, germa “b”, shuma të cilat duhet të kthehen në buxhetin e Bashkisë Poliçan.

Menjëherë

c. Për punonjësit, ■ 61,200 lekë, ■ 21,500 lekë, që kanë përfituar shpërblime për punë të mirë në masën e një page mujore nga fondi i veçantë për vitin 2011, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” pika 1, germa “c”, shuma të cilat duhet të kthehen në buxhetin e Bashkisë Poliçan.

Menjëherë

d. Për punonjësit ■ në masën 25,000 lekë, dhe ■ në masën 25,000 lekë, për përfitimin e pagës përkatëse për pushimet vjetore të pakryera për vitin 2010, në kundërshtim me VKM nr. 472, datë 02.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011” pika 1, germa “d”, shuma të cilat duhet të kthehen në buxhetin e Bashkisë Poliçan.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bexhet Zeqiri dhe Vasillaq Peci. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT